

30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Fq. 2


AMA vazhdon fushatën e Edukimit Mediatik, Krasniqi përballë 200 gjimnazistëve të Durrësit: Kujdes nga rreziqet e botës virtuale!

Tryezë ndërinstytucionale për keqinformimin në fushën e mjekësisë, kryetarja e AMA-s: Mesazhet e gabuara mund të rrezikojnë jetën e qytetarëve

Mbrojtja e shëndetit publik dhe lufta kundër dezinformimit shëndetësor bënë bashkë në një tryezë...



Fq. 2



Fq. 2

UNESCO prezanton gjetjet e studimit për Shqipërinë, mbi Platformat e Rrjeteve Sociale dhe Mediat Online

Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi, ka marrë pjesë në tryezën e punës me temë, "Platformat Digjitale dhe Qeverisja e Mediave Online..."

Thellohet bashkëpunimi mes AMA-s dhe rregullatorit të Polonisë, bien dakord për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta

Një takim pune mes Kryetares së AMA-s, Znj. Armela Krasniqi, dhe kreut të rregullatorit të Polonisë...



Fq. 2



Fq. 3

Efektet e mundshme, të dëmshme, të përdorimit të IA

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale (IA) ka sjellë shumë përfitime për njerëzimin...

AMA vazhdon fushatën e Edukimit Mediatik, Krasniqi përballë 200 gjimnazistëve të Durrësit: Kujdes nga rreziqet e botës virtuale!

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi, në kuadër të fushatës së nisur prej kohësh për Edukimin Mediatik, ndali në qytetin e Durrësit, ku para 200 të rinjve nga tre gjimnaze, i informoi mbi fenomene të ndryshme negative dhe rreziqe që bota virtuale fsheh, duke i treguar dhe mënyrat e mbrojtjes ndaj këtyre rreziqeve. Kryetarja e AMA-s u ka bërë thirrje gjimnazistëve të denoncojnë në çdo moment gjuhën e urrejtjes, rastet e bullizmit, seksizmit si dhe fenomeneve të tjera që përmban gjuha e urrejtjes.

[Lexo më shumë](#)



Tryezë ndërinstitucionale për keqinformimin në fushën e mjekësisë, kryetarja e AMA-s: Mesazhet e gabuara mund të rrezikojnë jetën e qytetarëve

Mbrojtja e shëndetit publik dhe lufta kundër dezinformimit shëndetësor bashkoi në një tryezë ndërinstitucionale drejtues të lartë. Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi, u shpreh se institucioni që ajo drejton është i hapur dhe i gatshëm për çdo kontribut të kërkuar nga profesionistët e fushës, qoftë ai edhe ligjor që premtet të përmirësojë këtë situatë. Ajo theksoi se mesazhet e gabuara nga të ashtuquajtur "mjekë", por pa licencë, apo të vetëquajtur "mjekë alternativë", mund të rrezikojnë jetën e qytetarëve. [Lexo më shumë](#)



UNESCO prezanton gjetjet e studimit për Shqipërinë, mbi Platformat e Rrjeteve Sociale dhe Mediat Online


Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi, ka marrë pjesë në tryezën e punës me temë, "Platformat Digjitale dhe Qeverisja e Mediave Online në Shqipëri", organizuar në Tiranë nga UNESCO. Në këtë takim u prezantuan gjetjet e studimit për Shqipërinë mbi Platformat e Rrjeteve Sociale dhe Mediat Online. Iniciativa e UNESCO-s për Qeverisjen e Platformave Digjitale, u konkretizua vitin e kaluar në Kroaci me miratimin e Rrjetit Global të Rrjeteve, ku Znj. Krasniqi mori pjesë, si kryetare e rrjetit MNRA. [Lexo më shumë](#)

Thellohet bashkëpunimi mes AMA-s dhe rregullatorit të Polonisë, bien dakord për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta



Një takim pune mes Kryetares së AMA-s, Znj. Armela Krasniqi, dhe kreut të rregullatorit të Polonisë, Z. Maciej Swirski në Varshavë, e ka ngritur në një stad tjetër bashkëpunimin mes dy rregullatorëve. Dy drejtuesit ranë dakord për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta. Si dhe shkëmbimin e ekspertizave dhe praktikave më të mira, të nevojshme për punën e secilit rregullator.

[Lexo më shumë](#)



Efektet e mundshme, të dëmshme, të përdorimit të IA

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale (IA) ka sjellë shumë përfitime për njerëzimin, por përdorimi i gabuar apo me keqdashje i IA-së mund të sjellë pasoja negative, ndonjëherë të rënda. Përhapja e shpejtë e dezinformimit dhe videot e manipuluar mund të jenë disa prej pasojave nga keqpërdorimi i IA-së.

[Lexo më shumë](#)